

PROCESVERBAL
nga seanca e gjashtëmbëdhjetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 3.11.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavilovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar në shërbimin profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e gjashtëmbëdhjetë të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e pesëmbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 20.10.2025.
2. Raport mbi prezantimin mediatik zgjedhor në rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale 2025.
3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërimit publik të operatorit "Viva Net" SHPKNJP Berovë, për shkelje të nenit 144, paragrafi (3) të LShMAAV.
4. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – shërbim: Transferimi i të dhënave.
5. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar nga seanca e 15-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 20.10.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori Trajçevski shpjegoi Raportin mbi prezantimin mediatik zgjedhor në rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale 2025. Ai shpjegoi se Raporti u zbatua në periudhën nga 29 shtator deri më 17 tetor dhe u realizua duke respektuar në mënyrë të saktë Metodologjinë për monitorimin e prezantimit mediatik zgjedhor përmes shërbimeve programore televizive dhe radio gjatë kohës së proceseve zgjedhore, për të cilën janë dhënë shembuj, teknikat e hulumtimit, si dhe të gjitha postulatet e tjera të nevojshme për të realizuar këtë hulumtim të komunikimit me bazë shkencore. Ai deklaroi se gjatë analizës së programeve, gjithsej 11 në numër që ishin objekt i analizës, Agjencia zbatoi teknikën kërkimore të analizës së përmbajtjes, e cila ofron të dhëna sasiore dhe cilësore, dhe në rastet kur kërkohej të kryhej analizë e tonit dhe kornizave, përdori analizë diskursive. Për ta bërë më të lehtë për transmetuesit përmbushjen e detyrave dhe detyrimeve të caktuara para tyre nga Kodi Zgjedhor, Këshilli i Agjencisë hartoi Udhëzues për transmetuesit për Zgjedhjet lokale 2025, në të cilat operacionalizoi pjesë nga këto detyrime dhe shtesa në bazë ditore, përmes shkrësive dhe njoftimeve, duke i përkujtuar rregullisht për detyrimet ligjore, të cilat së bashku me materialet e tjera rreth zgjedhjeve, ishin gjithashtu vazhdimisht të disponueshme në banerin e veçantë në ueb-faqen e Agjencisë, "Zgjedhjet lokale 2025". Monitorimi përfshiu 11 shërbime programore televizive kombëtare, tre prej të cilave janë të Shërbimit publik radiodifuziv Radio televizioni i Maqedonisë, RTM1, RTM2 dhe Kanali i Kuvendit, dhe tetë janë televizione komerciale, përkatësisht TV Alsat-M, TV Alfa, TV Kanal 5, TV Sitel, TV Telma, TV 24 Vesti, TV 21-M dhe TV Shenja. U përfshinë shërbime që transmetohen në maqedonisht dhe shqip dhe së bashku arrijnë pjesën më të madhe të shikueshmërisë në vend, me qëllim që të marrin informacion rreth procesit zgjedhor. Për shërbimet e tjera programore u veprua në bazë të ankesave. Detyrimi themelor i transmetuesve ishte të raportonin për procesin zgjedhor në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme, në përputhje me nenin 75 paragrafi (1) dhe 75-a paragrafi (1), pika v të Kodit Zgjedhor, dhe për ta arritur këtë, transmetuesit duhej të respektonin parimet e barazisë dhe proporcionalitetit, që në fakt do të thotë se balanca në këtë mënyrë sigurohet në kontinuitet duke respektuar parimin e barazisë, afërsisht kohë të barabartë për kandidatët, dhe për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit parimin e proporcionalitetit, kohë afërsisht të barabartë për pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore me numër të njëjtë listash të konfirmuara të kandidatëve dhe me të njëjtin intesitet të fushatës. Nga ana cilësore, bilanci arrihet me qasje të barabartë ndaj raportimit, përkatësisht tonin dhe kornizat. Radiotelevizioni i Maqedonasë ka dhe detyrim shtesë, të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, sipas të cilit koha e raportimit në edicionin qendror të TV Dnevnik në përqindje duhet të ndahet si më poshtë: 30% e kohës për ngjarjet ditore nga vendi dhe bota, 30% për aktivitetet e partive politike në pushtet, 30% për partitë politike në opozitë, 10% për aktivitetet jashtë partive politike parlamentare dhe për kandidatët e pavarur. Gjithashtu, transmetuesit kishin detyrimin të përshtatnin metodën e raportimit për personat me aftësi të kufizuara shqisore, në përputhje me Kodin Zgjedhor. Agjencia gjithashtu zbatoi dhe monitorim për respektimin e heshtjes zgjedhore dhe në rrethin e parë dhe në rrethin e dytë, dhe gjatë kohës së rrethit të parë zgjedhor, u konstatuan 4 shkelje në 4 transmetues, për të cilat Këshilli ngriti procedura

kundërvajtëse, për 2 transmetues procedura është përfunduar me aktgjykim fajësie, për 2 transmetuesit e tjerë procedurat janë në Gjykatën e Apelit në Shkup. Ai më tej shpjegoi se është treguar se me rritjen e numrit të kandidatëve në çdo proces zgjedhor, bëhet gjithnjë e më e vështirë, madje e pamundur, të respektohen plotësisht parimet, sepse koha në lajme është e kufizuar, si dhe mundësitë teknike dhe kadrovike, pra kapacitetet e stacioneve televizive janë të kufizuara, dhe madje edhe stacionet më të mëdha televizive nuk janë mjaftueshëm të mëdha për të mbuluar aktivitetet e të gjithë kandidatëve që ishin të përfshirë në fushatën zgjedhore. Për Zgjedhjet lokale të vitit 2025, në zgjedhje morën pjesë deri në 153 pjesëmarrës me lista të konfirmuara kandidatësh, nga të cilët 9 ishin parti parlamentare, 24 parti jashtëparlamentare dhe 120 kandidatë të pavarur. Në Raport janë renditur të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Raportimi në programet e lajmeve ditore, të realizuara sipas zhanreve përmes lajmeve (njëra pas tjetrës) dhe raportimeve, u zhvillua më shumë për inerci sesa nga mjedisi i përgjithshëm socio-politik zgjedhor dhe u kushtëzuan kryesisht nga numri i madh i kandidatëve për kryetarë bashkie dhe këshilltarë në 81 njësitë ekzistuese të vetëqeverisjes lokale (80 komuna dhe Qyteti i Shkupit). Me fjalë të tjera, edhe nëse redaksitë informative e stacioneve televizive kombëtare të angazhonin të gjithë potencialin e tyre teknik dhe kadrovik, nuk do të ishin në gjendje të shpërndanin në mënyrë ideale, të drejtë, të balancuar dhe të paanshme ndarjen e kohës së informative që në mënyrë gazetarske dhe editoriale të hartojnë dhe prodhojnë në edicionet televizive të lajmeve, në mënyrë që të përmbushnin kërkesat e Kodit Zgjedhor. Në fakt, një edicion i një programi qendror ditor lajmesh zgjaste mesatarisht nga 30 deri në 40 minuta, dhe nga kjo minutazhë, e krijuar posaçërisht dhe e ashtuquajtur "kronikë zgjedhore", ishte e shkurtër dhe e mbushur kryesisht me deklarata/pika të shkurtra nga pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Prandaj, si një formë televizive tashmë e vendosur dhe e zakonshme, "kronika zgjedhore" është domosdoshmërisht monotone dhe përsëritëse, dhe krijon më shumë një shfaqje të automatizuar, formale, stereotipike të një tabloje TV- zgjedhore, sesa ofron një përfaqësim të qartë të një oferte zgjedhore reale dhe të larmishme, si bazë për një vlerësim relevant dhe vlerësim informativ të shikuesit si votues potencial. Përballë kësaj situatë, redaksitë e 11-të shërbimeve programore televizive, që iu nënshtruan mbikëqyrjes në përgjithësi mbajtën dy qëndrime editoriale në lidhje me prezantimin mediatik zgjedhor në lajme/gazetat e përditshme: Disa bënë një përpjekje të konsiderueshme për të ofruar informacion për më shumë pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, duke përfshirë sa më shumë parti joparlamentare dhe kandidatë të pavarur, siç pritej, kohën që ishte më e rëndësishme për subjektet politike që kishin më shumë lista kandidatësh të konfirmuarnë edhe fushatën më intensive. Në këtë grup përfshihet RTM1 (me informacion mbi kandidatët e të gjitha 9 partive parlamentare, 7 partive joparlamentare dhe 21 grupe votuesish) dhe RTM2 (me informacion mbi kandidatët e të gjitha 9 partive parlamentare, 7 partive joparlamentare dhe 23 grupe votuesish) nga Shërbimi publik radiodifuziv. Nga mediat komerciale, shtrirje më të madh të pjesëmarrësve në zgjedhje siguroi TV Alfa (7 parti parlamentare, 7 parti joparlamentare dhe 20 grupe votuesish). Pastaj Kanal 5 (me informacion rreth 7 partive parlamentare, 7 partive joparlamentare dhe 8 grupe votuesish) dhe Telma (me informacion rreth 7 partive parlamentare, 5 partive joparlamentare dhe 7 grupe votuesish). Stacionet e tjera televizive të analizuara u përqendruan në fushatën e partive parlamentare me pak informacion rreth partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur. Pavarësisht për cilën politikë editoriale vendosën, redaksitë informative plotësisht nuk mund të përmbushnin detyrimin për mbulim të balancuar të procesit zgjedhor bazuar në parimet e barazisë dhe proporcionalitetit në emisione informative ditore. Dallimi është se të parat, të cilat ofronin informacione për një numër më të madh pjesëmarrësish në fushatën zgjedhore, ishin

më afër përmbushjes së thelbit të këtyre parimeve - t'u ofronin qytetarëve sa më shumë të dhëna mbi të cilat të bazonin vendimin e tyre për ditën e votimit. Të dytat, nga ana tjetër, pasqyronin status quo-në politike të pjesëmarrjes të "lojtarëve të mëdhenj", të cilën vetëm disa po përpiqen të nxisin, thënë kushtimisht "lojtarë më të vegjël". Për temën zgjedhje më shumë kohë në lajme ndanë TV Alsat-M, pothuajse 8 orë, TV Sitel pothuajse 7 orë dhe TV Alfa 4:49:24 orë. Të gjitha mediat e analizuar në përgjithësi raportuan në mënyrë neutrale për pjesëmarrësit në zgjedhje, përveç TV Alfa, e cila fillimisht raportoi informacione pozitive për VMRO-në dhe informacione negative për koalicionet e udhëhequra nga LSDM dhe BDI, por me publikimin e Raportit të miratuar nga Këshilli për monitorim të Agjencisë para fillimit të fushatës, e përshtati transmetimin e programeve të lajmeve ditore në përputhje me Kodin Zgjedhor. Kur shihet Raporti në tërësi, mediat në përgjithësi e respektuan Kodin Zgjedhor dhe nuk propozohet shqiptimi i procedurës kundërvajtëse kundër asnjërit prej shërbimeve televizive dhe programore të lartpërmendura.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, deklaroi se Raporti ishte përgatitur plotësisht dhe i qartë. Ai theksoi se gjithçka ishte e kuptueshme dhe shprehu mirënjohje ndaj mediave, veçanërisht atyre që në emisionet ditore informative raportuan në përputhje me ligjin.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin mbi prezantimin mediatik zgjedhor në rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale 2025, nr. 10-4639/1 datë 31.10.2025.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës - paralajmërim publik të operatorit "Viva Net" SHPKNJP Berovë, për shkak të shkeljes së nenit 144 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV). Ajo shpjegoi se operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik janë të detyruar vazhdimisht të dërgojnë sinjalin që e ofrojnë tek shfrytëzuesit e fundit dhe në vendin për mbledhjen e sinjalit - pikë e veçantë nga e cila sinjali më tej shpërndahet në Agjencion. Nga mbikëqyrja e kryer u konstatua se operatori "Viva Net" nga Berova nuk e përmbush këtë detyrim ligjor, përkatësisht nuk e dërgon sinjalin në Agjenci, për këtë arsye propozohet shqiptimi i masës paralajmërim publik.

Drejtori Trajčevski shtoi se operatori duhet ta mënjanon shkeljen e Ligjit në afat prej 30 ditësh. Pas skadimit të këtij afati, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse sinjali i dërgohet Agjencisë, përkatësisht nëse operatori i ka respektuar dispozitat ligjore. Nëse kjo nuk bëhet, Këshilli do të ngrejë procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer të jashtëzakonshme programore nr. 11-4429/1 datë 17.10.2025 dhe njëzëri konkludoi që SHTR – operator i rrjetit kabllor "Viva Net" SHPKNJP Berovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 144 paragrafi (3) të LShMAAV. Në përputhje me pikën 9 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.1-4241/1 datë 1.10.2025, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga pranimi i Aktvendimit ta harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat ligjore.

Nga mbikëqyrja u konstatua se operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik "Viva Net" SHPKNJP Berovë, që në përputhje me notifikacionin e Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të ushtrojë veprimtari në territorin e komunës së Berovës dhe Pehçevë, nuk

e dërgon vazhdimisht sinjalin me përmbajtje të tillë e cila është në dispozicion të parapaguesve në lokacionet për mbledhjen e sinjaleve në nivel rajonal, për shpërndarjen e mëtejshme në sistemin e mbikëqyrjes së programeve të Agjencisë në Shkup, që është shkelje e nenit 144 paragrafi (3) të LShMAAV.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj operatorit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të përcaktojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja e Spektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, Cvetanka Mitrevska shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Bartja e të dhënave. Ajo shpjegoi se Agjencia ka marrë me qira hapësirë për vendosjen(kolokacion) e pajisjeve të veta në tetë lokacione në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Veles, Kumanovë, Shtip, Strumicë, Manastir, Ohër, Dibër dhe Tetovë - të cilat, së bashku me lokacionin qendror në Shkup, duhet të jenë të lidhura në një rrjet korporativ të vetëm të të dhënave. Prandaj, ekziston nevoja për të siguruar lidhje korporative të integruar dhe të sigurt të të dhënave në këto lokacione përmes infrastrukturës së përshtatshme territoriale. Në këtë drejtim, është e nevojshme të zbatohet procedurë për furnizim publik të shërbimit "Bartja e të dhënave", e cila është parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik, me fonde të parashikuara në Planin financiar të Agjencisë për vitin 2025, dhe do të plotësohet dhe në Planin financiar për vitin 2026, pasi kontrata që do të rezultojë nga kjo procedurë do të zbatohet për një periudhë prej dy vitesh. Sipas vlerës së parashikuar, procedura do të realizohet si një procedurë e hapur e thjeshtuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Do të fillojë me publikim të njoftimi në Sistemin elektronik për furnizime publike (SEFP) dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Mitrevska shtoi se të gjitha informacionet shtesë në lidhje me këtë procedurë përfshihen në materialet e dorëzuara anëtarëve të Këshillit për këtë seancë.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli theksoi se në materialet sipas kësaj pike theksohet se procedura për furnizim publik do të realizohet pa ankand elektronik dhe kërkoi shpjegim më të detajuar për këtë.

Udhëheqësja e Spektorit për çështje juridike dhe furnizime publike Cvetanka Mitrevska, sqaroi se procedura do të kryhet pa ankand elektronik sepse Ligji për furnizime publike e lejon këtë, dhe Byroja për furnizime publike rekomandon së paku 40% të procedurave gjatë vitit të realizohen pa përdorur ankand elektronik. Ajo informoi më tej se, duke filluar nga viti 2026 të gjitha procedurat do të realizohen pa ankand elektronik.

Në pyetjen shtesë të këshilltares Vërzivolli se si do të mbërrijnë ofertat në kuadër të procedurës, Mitrevska shpjegoi se i gjithë procesi do të zhvillohet përmes Sistemit elektronik për furnizime publike (SEFP), nga ku oferta e përzgjedhur do të jetë përfundimtare, pa mundësinë për ulje shtesë të çmimit të ofruar.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se Agjencia mori paralajmërim nga Byroja për furnizim publik, sepse kishte zbatuar numër të madh ankandesh elektronike dhe kishte tejkaluar përqindjen e lejuar prej 40%. Prandaj, deri në fund të vitit, të gjitha procedurat do të duhet të zbatohen pa ankand elektronik, në mënyrë që të arrihet raporti i përcaktuar në përputhje me rekomandimet e Byrosë. Ai shtoi se një dispozitë e tillë është pjesërisht e palogjikshme, por e tillë është rregullativa ligjore dhe Agjencia duhet të veprojë në përputhje me të.

Udhëheqësja Mitrevska sqaroi shtesë se, sipas analizës së kryer nga Byroja për furnizime publike, është treguar se ofertat janë më të pranueshme dhe ekonomike kur procedurat realizohen pa ankand elektronik. Gjatë realizimit të ankandit, operatorët ekonomikë shpesh i rrisnin çmimet fillestare, duke pritur që më vonë t'i ulnin gjatë ankandit. Prandaj, siç theksoi ajo, këto dy furnizime publike, si dhe të gjitha ato pasuese deri në fund të vitit, do të realizohen pa ankand elektronik.

Këshilltari Petar Xhurovski vazhdoi me pyetje në lidhje me mënyrën e përzgjedhjes së ofertave, duke theksuar se është e rëndësishme të bëhet dallimi midis përzgjedhjes sasiore dhe cilësore, përkatësisht që furnizimi publik duhet të bazohet në kriterë cilësorë, dhe jo në veçanti në parametrat e çmimit (kvantitativ).

Drejtori Trajčevski shpjegoi se ky furnizim publik është me rëndësi thelbësore, pasi mundëson përgatitjen e raporteve, siç është raporti që ishte objekt shqyrtimi, si dhe raportet e monitorimit. Ai theksoi se pa transmetim të sigurt të të dhënave nga tetë lokacionet në vend, Agjencia nuk do të jetë në gjendje të marrë sinjale nga televizionet brenda vendit, që do ta bënte të pamundur monitorimin e programeve nga lokacioni qendror në Shkup. Drejtori informoi se pajisjet e Agjencisë janë sistemuar në kuadër të Makedonski Telekom, ku paguhet kompensim për lokacion. Ai theksoi se për monitorim të suksesshëm nevojitet regjistrim cilësor, jo vetëm shërbim i lirë, sepse transmetimi me cilësi të dobët do ta bënte të pamundur kryerjen e mbikëqyrjes mbi shërbimet programore. Ai më tej theksoi se shërbimi "Bartja e të dhënave" ofrohet nga një numër i vogël kompanish, por se Agjencia deri më tani ka pasur një përvojë pozitive me operatorët që e kanë ofruar këtë shërbim. Trajčevski theksoi se mendimi i tij personal nuk është në përputhje të plotë me qëndrimin e Byrosë për furnizime publike, pasi Agjencia, përmes përdorimit të ankandit elektronik, deri më tani ka arritur ulje të konsiderueshme të çmimeve dhe kursime vjetore. Megjithatë, duke pasur parasysh se kjo parashihet në Ligjin për furnizime publike, Agjencia do të duhet t'i përmbahet rregullave të përcaktuara dhe në të ardhmen do të zbatojë procedura pa ankand elektronik.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli pyeti nëse mund të aplikojë edhe person fizik, sepse ajo që lexoi në materialet e paraqitura për pikën, përkatësisht personi që posedon çertifikata përkatëse.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike Cvetanka Mitrevska u përgjigj se kjo ishte e vërtetë, por theksoi se personi duhet të përmbushë kushte të caktuara që janë të detajuara në kërkesën për fillimin e procedurës, si dhe në kërkesën për dhënien e kontratës, ku janë definuar kriteret dhe kërkesat teknike.

Drejtori Trajčevski shpjegoi se në të kaluarën shërbimi përbartje të sinjalit ofrohej nga kompani të tilla si A1 dhe Makedonski Telekom, por se në një nga vitet e mëparshme, u zgjodh një kompani që rezultoi problematike dhe e paaftë për të ofruar shërbim në nivelin e kërkuar, prandaj Agjencia u detyrua të ngrejë procedurë gjyqësore, dhe më pas kompania u tërhoq nga kontrata. Ai theksoi se vetëm kompanitë më të mëdha të telekomunikacionit kanë kapacitet real për të ofruar këtë shërbim, por se Agjencia, në përputhje me Ligjin për furnizim

publik, nuk mund drejtpërdrejt ta deklarojë këtë në dokumentacionin e tenderit, por duhet të vendosë kushte objektive teknike që indirekt i kufizojnë ofertuesit sipas aftësive të tyre reale.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për të kryer procedurën për furnizim publik - shërbim: Bartja e të dhënave.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën bartja e të dhënave është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-3061/1 datë 21.7.2025 (Tekst i pastruar), ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, gjegjësisht do të sigurohen shtesë me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë. Ajo shpjegoi se Agjencia zotëron pesë automjete zyrtare, të cilat përdoren për të përmbushur nevojat zyrtare. Gjithashtu, në selinë e Agjencisë gjendet dhe është instaluar një gjenerator që siguron mbushje të energjisë elektrike të objektit në rast të ndërprerjes së rrjetit të rregullt. Për këtë shkak, lindi nevoja për zbatimin e procedurës për furnizim publik për benzinë motorike dhe naftë për nevojat e Agjencisë. Furnizimi është parashikuar në Planin vjetor për furnizim publik, i cili është një parakusht themelor për zbatimin e procedurës. Sipas Ligjit për furnizim publik, fondet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për vitin 2025, dhe do të sigurohen pjesërisht me Planin financiar për vitin 2026, pasi kontrata që do të rezultohet nga kjo procedurë, e ngjashme me atë të mëparshmen, do të jetë e vlefshme për një periudhë prej dy vjetësh. Sipas vlerës së parashikuar, procedura do të zbatohet si procedurë e hapur e thjeshtuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik për këtë lloj procedure. Procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në Sistemin Elektronik për furnizim publik (SEFP) dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut". Mitrevska shtoi se të gjitha të dhënat shtesë për procedurën përmbahen në materialet e paraqitura për këtë seancë.

Këshilltari Petar Xhurovski kërkoi shpjegim më të detajuar në lidhje me automjetet zyrtare të Agjencisë.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi se automjetet ndodhen në Agjenci dhe përdoren nga shoferët, të cilët e kanë këtë si detyrë pune, si dhe nga punonjës të tjerë të autorizuar të Agjencisë. Ajo theksoi se për çdo përdorim mbahen evidenca përkatëse dhe plotësohet fletudhëtim.

Këshilltari Xhurovski pyeti gjithashtu nëse kryetari i Këshillit mund të përdorë automjet zyrtar për nevoja dhe angazhime zyrtare.

Mitrevska u përgjigj se kjo është e mundur dhe se të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë nevojë, gjithashtu mund të përdorin edhe automjete zyrtare.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik – mallra: Karburant për nevojat e Agjencisë.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën karburant për nevojat e Agjencisë është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2025

të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-3061/1 datë 21.7.2025 (tekst i pastruar), ndërsa mjetet janë siguruar nga Planin financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2025, gjegjësisht do të sigurohen shtesë me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 6

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**